

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundi mit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
1	11.01.2026	<p>1. Cilat janë kërkesat ligjore dhe procedurat për licencimin e pilotëve të balonave në Shqipëri</p> <p>2. A lejohet zhvillimi i trajnimeve praktike dhe teorike brenda territorit të Shqipërisë nga instruktorë të huaj të certifikuar</p> <p>3. Cilat janë hapat për marrjen e lejeve të operimit për fluturime turistike me balona</p> <p>4. A kërkohet miratim paraprak për përdorimin e zonave të caktuara për ngritje dhe ulje</p> <p>5. A ka dokumentacion, formularë apo udhëzime zyrtare që duhet të plotësohen për këtë proces</p>	20.01.2026	<p><b>I. LICENCIMI</b></p> <p><b>1. Cilat janë kërkesat ligjore dhe procedurat për licencimin e pilotëve të balonave në Shqipëri?</b></p> <p>Ju informojmë se licencimi i pilotëve të balonave (BPL – Balloon Pilot Licence) dhe organizatave të trajnimit kryhet bazuar në: Urdhrin e Ministrit nr. 306, datë 6.12.2024 për miratimin e rregullores, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”; Urdhrin e Ministrit nr.</p>	E plotë	S’ka

				<p>178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores mbi kërkesat teknike dhe procedurat administrative që lidhen me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, i ndryshuar, që transponon Rregulloren (BE) nr. 1178/2011; si dhe Urdhrin e Ministrit nr. 218, datë 29.12.2023, “Për miratimin e rregullores për pranimin e certifikimeve të pilotëve nga vendet e treta”, që transponon Rregulloren (BE) nr. 723/2020.</p> <p>1. Kërkesat e përgjithshme për licencën e pilotit BPL (BFCL):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Moshë minimale për lëshimin e BPL: 16 vjeç; fluturime solo për studentët lejohen nga 14 vjeç, nën mbikëqyrje të instruktorit FI(B);</li> <li>• Përfundimi i një kursi trajnimi në një ATO ose DTO të certifikuar nga AAC;</li> <li>• Minimumi 16 orë fluturim trajnues;</li> <li>• Kalimi i provimeve të njohurive teorike dhe kryerja me sukses e testit praktik të aftësive;</li> <li>• Aplikanti për BPL duhet të mbajë një certifikatë</li> </ul>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>mjekësore të vlefshme të paktën Klasa LAPL, të lëshuar nga një Ekzaminues Aeromjekësor (AME) i miratuar nga AAC, ose Qendër Aeromjekësore (AeMC) e certifikuar nga AAC;</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Aplikanti duhet të demonstrojë aftësi gjuhësore në gjuhën angleze, në përputhje me kërkesat e ICAO Language Proficiency. Niveli minimal i kërkuar është ICAO Level 4 (Operational).</li></ul> <p>Pranimi i licencave të huaja për pilotët:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Licencat e ekuipazhit fluturues të lëshuara nga një Shtet Anëtar i BE-së, në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1178/2011 (Pjesa FCL), pranohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë, me kusht verifikimin e vlefshmërisë, privilegjeve dhe certifikimit mjekësor.</li><li>• Licencat e ekuipazhit fluturues të lëshuara nga vende të treta do të validohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë në përputhje me Urdhrin e Ministrit nr. 218, datë 29.12.2023. Validimi i licencës</li></ul>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>duhet të bëhet përpara ushtrimit të privilegjeve të licencës në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Licencat duhet të përfshijnë:</li> <li>• kategorinë përkatëse të licencës dhe privilegjet;</li> <li>• tip të vlefshëm, instrumentet dhe klasën, sipas rastit;</li> <li>• një certifikatë mjekësore të vlefshme (Pjesa MED), të lëshuar ose të pranuar nga autoriteti kompetent.</li> </ul> <p>2. Instruktorët e huaj të certifikuar mund të angazhohen në zhvillimin e trajnimit teorik dhe praktik, me kusht që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të jenë mbajtës të licencës dhe certifikatës të vlefshme instruktori të lëshuara nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar të EASA-s dhe të njihen nga Autoriteti i Aviacionit Civil, përkatësisht sipas kërkesave të pjesës BFCL;</li> <li>• të jenë të përfshirë në programin e trajnimit të ATO/DTO-së të certifikuar nga AAC.</li> </ul> <p>2. <b>A lejohet zhvillimi i trajnimeve praktike dhe</b></p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p><b>teorike brenda territorit të Shqipërisë nga instruktorë të huaj të certifikuar?</b></p> <p>Organizatat e Trajnimit ATO/DTO</p> <p>Aktualisht në Shqipëri nuk kemi asnjë organizatë trajnimi që ofron trajnime për pilotët e balonave.</p> <p>AAC certifikon organizata trajnimi me “principal place of business” në Shqipëri dhe/ose pranon organizata trajnimi të certifikuara nga një shtet anëtar i EASA-s sipas legjislacionit dhe procedurave në fuqi.</p> <p><b>II. OPERIMI</b></p> <p>Lidhur me kërkesat e operimit ajror për balonat, SOF, ju informon se sipas Urdhër Nr. 306, Datë 6.12.2024, Për Miratimin E Rregullores, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimin e balonave, si dhe për licencimin e ekuipazhit të fluturimit për balonat”:</p> <p>1. Operatorët e balonave duhet të operojnë me balonën në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nënpjesën BAS</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>të aneksit II, të kësaj Rregulloreje.</p> <p>2. Operatorët e balonave kanë të drejtë të angazhohen në operime të tilla tregtare vetëm pasi të kenë deklaruar tek Autoriteti i Aviacionit Civil kapacitetin dhe mjetet e tyre për të përmbushur përgjegjësitë që lidhen me operimin e balonës.</p> <p>Si dhe plotësimin e kërkesave të Aneksit II: Operimet ajrore të balonave, [pjesa BOP], nënpjesa BAS, kërkesat bazë të operimit dhe Nënpjesa ADD, Kërkesat shpesh për operimet tregtare. Në deklaratën e përmendur në nënparagrafin e dytë të nenit 3(2), operatori duhet të konfirmojë që operatori respekton dhe do të vazhdojë të përmbushë kërkesat thelbësore të përcaktuara në aneksin V të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, të ndryshuar, dhe me kërkesat e kësaj Rregulloreje;</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>Operatori duhet të përfshijë në deklaratë të gjitha informacionet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Emrin e operatorit;</li><li>2. Vendin ku operatori ka vendin e tij kryesor të biznesit;</li><li>3. Emrin dhe detajet e kontaktit të menaxherit përgjegjës të operatorit;</li><li>4. Datën e fillimit të operimit tregtar dhe, sipas rastit, datën në të cilën ndryshimi i një operimi ekzistues tregtar hyn në fuqi;</li><li>5. Në lidhje me të gjitha balonat e përdorura për veprimtarinë tregtare, llojin e balonës, regjistrimin, bazën kryesore, llojin e operimit dhe organizatën e menaxhimit të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore.</li></ol> <p>Komentet e Vlefshmerire Ajrore:</p> <p>Në mënyrë që balonat të operojnë në Republikën e Shqipërisë, ato duhet të pajisen me <b>Certifikatë Regjistrimi (CoR)</b> dhe <b>Certifikatë të Vlefshmërisë Ajrore (CofA)</b>.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>Për të mundësuar fillimin e procesit të regjistrimit të balonës nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (ACAA), kërkohen dokumentet e mëposhtme:</p> <p><b>Dokumentet për regjistrim (CoR):</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>a) Formulari i aplikimit <b>ACAA-DFS-AIM-105</b></li><li>b) Dëshmia e pronësisë (kontrata e shitjes) ose marrëveshja e qirasë</li><li>c) Certifikata e çregjistrimit (nëse balona ishte regjistruar në një vend tjetër)</li><li>d) Sigurimi i mjetit fluturues</li><li>e) Certifikata e Vlefshmërisë Ajrore (CofA) e mëparshme</li><li>f) Certifikata e Rishikimit të Vlefshmërisë Ajrore (ARC) e mëparshme</li><li>g) Certifikata e Regjistrimit (CoR) e mëparshme</li></ul> <p><b>Dokumentet për lëshimin e Certifikatës së Vlefshmërisë Ajrore (CofA):</b></p> <p>Pas regjistrimit, për të marrë CofA, operatori duhet të ketë kontratë me një organizatë <b>CAMO</b> dhe <b>Part-145</b> ose një</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p><b>organizatë të miratuar sipas Pjesës CAO nga Autoriteti i Aviacionit Shqiptar.</b></p> <p>Disa nga dokumentet kryesore të kërkuara për lëshimin e CofA janë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Type Certificate (TC) ose Restricted Type Certificate (RTC)</b></li><li>• <b>Type Certificate Data Sheet (TCDS)</b></li><li>• <b>Approved Maintenance Programme (AMP)</b></li><li>• <b>Airworthiness Review (AR)</b></li></ul> <p>Për lëshimin e CoR dhe CofA, ju lutemi referojuni Urdhërit të Ministrit Nr.57 datë 13.03.2024 “Për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit” që përfron plotësisht rregulloren e Komisionit (BE) nr.</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>748/2012 e datës 3 gusht 2012 dhe;</p> <p>Urdhërit të Ministrit Nr. 115, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për kërkesat, përmbajtjen e regjistrit dhe procedurat e regjistrimit, çregjistrimit ose ndryshimit të të dhënave në regjistrin e avionëve civilë të republikës së shqipërisë”.</p> <p>Përsa i përket organizatave CAMO, Part-145 dhe CAO, ju lutemi referojuni Urdhërit të Ministrit Nr. 79, datë 15.4.2024 “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të mjeteve ajrore dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit tëpërfshirë në këto detyra”, që për afron plotësisht rregulloren e Komisionit (BE) nr. 1321/2014.</p>		
2	14.04.2026	I am interested in pursuing a 1-year diploma or short course in Airport Management	20.04.2026	Albanian Civil Aviation Authority does not provide or deliver training courses directly. ACAA is the competent authority responsible for regulating and overseeing training, including the certification and	E plotë	S’ka

				<p>supervision of training organisations that deliver courses leading to the issuance of licences.</p> <p>To attend relevant aviation training courses, we recommend contacting certified aviation training organisations. You may find suitable courses through:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• The European Union Aviation Safety Agency (EASA) website, which provides information on approved training organisations and courses;</li> <li>• EUROCONTROL training services (<a href="https://learningzone.eurocontrol.int/">https://learningzone.eurocontrol.int/</a>);</li> <li>• International organisations such as IATA (<a href="https://www.iata.org/">https://www.iata.org/</a>);</li> <li>• National aviation authorities or other training organisations that you can find online.</li> </ul>		
3	16.04.2026	Kerkoj informacion lidhur me trajnimin dhe licensimin si Kontrollor i Trafikut Ajror; si mund te aplikoj per trajnimin fillestar si Student ATCO? Sa i takon konkursit, a	20.04.26	Sipas kërkesave rregullatore, aplikimi për licencë KTA kryhet pranë ALBCONTROL, në momentin kur kjo e fundit shpall thirrjen për		

		<p>mund te kem informacion lidhur me datat e celjes?</p>		<p>aplikime. ALBCONTROL është Ofruesi i Shërbimit të Navigimit Ajror në Republikën e Shqipërisë dhe i vetmi institucion i autorizuar për trajnimet dhe përzgjedhjen e kandidatëve për këtë licencë. Bazuar në Urdhrin e Ministrit Nr. 171, datë 11.11.2025, i cili transponon Rregulloren e Komisionit Evropian Nr. 2015/340, kapitulli KTA.B.001, pika (b), aplikanti për licencën e student-kontrollorit të trafikut ajror duhet të plotësojë këto kushte:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të jetë të paktën 18 vjeç;</li> <li>2. Të ketë përfunduar me sukses trajnimin fillestar në një organizatë trajnimi, të certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;</li> <li>3. Të ketë një certifikatë mjekësore të vlefshme;</li> <li>4. Të ketë dëshmuar një nivel të përshtatshëm të aftësisë gjuhësore, sipas kërkesave të përcaktuara në KTA.B.030.</li> </ol> <p>Për më shumë informacion mbi procedurat dhe kërkesat, ju ftojmë të konsultoni Materialin Udhëzues në faqen zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil, në linkun më poshtë:</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<a href="https://www.aac.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/ACAA-DTL-GM1-ATCL-GUIDANCE-ON-ISSUE-REVALIDATION-RENEWAL-SUSPENSION-AND-REVOICATION-CATEGORIES-AND-ENDORSEMENT-TEMPORARY-AUTHORIZATIONS-AND-EXCHANGE-OF-AIR-TRAFFIC-CONTROLLERS-LICENSES.pdf">https://www.aac.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/ACAA-DTL-GM1-ATCL-GUIDANCE-ON-ISSUE-REVALIDATION-RENEWAL-SUSPENSION-AND-REVOICATION-CATEGORIES-AND-ENDORSEMENT-TEMPORARY-AUTHORIZATIONS-AND-EXCHANGE-OF-AIR-TRAFFIC-CONTROLLERS-LICENSES.pdf</a> <b>Ju rikujtojmë</b> se licencat e lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil janë licenca kombëtare dhe vlejnë vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.		
4	20.4.26	Dron me peshe 151g. A është e nevojshme të pajisem me certifikate ose leje përdorimi për këtë lloj droni? .	21.4.26	Bazuar në Urdhrin e Ministrit Nr. 143, datë 18.07.2022, ju informojmë se regjistrimi i operatorit kërkohet edhe për dronët me masë nën 250 gram, vetëm në rast se droni është i pajisur me kamera ose sensorë të aftë për regjistrimin e të dhënave personale. Në rast se droni nuk ka kamerë apo sensorë për regjistrim të dhënash, atëherë nuk kërkohet regjistrim apo pajisje me certifikatë. Më shumë informacion lidhur me kategoritë e dronëve, kërkesat		

				për regjistrim dhe përdorimin e tyre mund të gjeni në këtë link : <a href="https://www.aac.gov.al/regjistrimi-si-operator-id-e-operatorit/">https://www.aac.gov.al/regjistrimi-si-operator-id-e-operatorit/</a>		
--	--	--	--	--	--	--